



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCC-10-0127

Paditësi

Z A Prishtinë.

Kundër

E paditura

K “K E” – F K, përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), rr. “Dritan Hoxha”, nr.55,
Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj, gjyqtari kryesues, Diellza Hoxha dhe Hajrie Shala, gjyqtare, pas seancës degjimore dhe seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15 nëntor 2022, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Gjykata jep pëlqimin për tërheqjen padisë, ashtu që padia e paditësit konstatohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 14 qershor 2010, paditësi ka paraqitur padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (tutje DHPGJS), kundër të paditurës K “K E” – F K. Paditësi përmes padisë ka kërkuar vërtetimin e pronësisë për ngastrën nr.472, në sipërfaqe prej 0.16,90 ha, dhe ngastrën nr. 473, me sipërfaqe prej 0.09,33 ha evidentuar në ZK C. Ka shtuar se këto ngastra i ka në posedim me mirëbesim dhe i shfrytëzon në vazhdimësi më shumë se 20 vite të pandërprerë pa kurrfarë pengesa apo shqetësimi.

Paditësi bazën juridike për fitimin e pronësisë e mbështetë në bazë të parashkrimit fitues, komfor dispozitës së nenit 40 par. 1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat Sendore të Republikës së Kosovës. I ka propozuar Gjykatës që padinë e tij ta aprovoj si të bazuar.

Me 21 tetor 2010, DHPGJS me aktvendimin SCC-10-0127, padinë e paditësit kundër AKP-se e ka hedhë poshtë si të papranueshme.

Me 16 korrik 2014. e paditura AKP-ja ka paraqitur mbrojtje në padi dhe e ka kontestuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se paditësi nuk ka prezantuar asnjë provë të besueshme në mënyrë që gjykata t'ia falë besimin. Ka shtuar se prona që është objekt i kontestit është në emër të paditurës K- "K E" në F K.

Tutje e paditura AKP ka pohuar se e drejta e pronësisë nuk fitohet me deklaratat e dëshmitarëve dhe nuk është me rendësi se sa vite paditësi e ka punuar token kontestuese, por është e rëndësishme që të vërtetohet se si paditësi është futur në posedim të kësaj prone. AKP ka shtuar se paditësi nuk ka legjitimitet real për procedimin e kësaj çështje, sepse nuk ka prezantuar dëshmi se ai ka pasur raporte materialo-juridike me të paditurën. I ka propozuar gjykatës që ra refuzoj padinë e paditësit.

Me 30 dhjetor 2014, paditësi ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen e AKP-së.

Me 05 korrik 2017, AKP ka paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e paditësit.

Me 16 janar 2018 DHPGJS, i ka ftuar palët për një seancë dëgjimore për datën 20 shkurt 2018.

Me 07 shkurt 2018, paditësi përmes parashtrësës e ka njoftuar gjykatën se Bordi i Drejtoreve të AKP-se, me datën 30 nëntor dhe 1 dhe 6 dhjetor 2016 ka aprovuar rekomandimin për shitje me negociim direkt të paluajtshmerive të cilat janë objekt kontesti, andaj i ka kërkuar gjykatës që të ndërpres procedurën në këtë çështje deri në përfundimin e shitjes me negociim direkt. Parashtrësës në fjalë paditësi i ka bashkangjitur shkresën informuese të dt. 19 dhjetor 2017 se bashku me vendimin e Bordit të AKP-se numër referencës BD-101/2013.

Me 20 shkurt 2018, gjykata ka mbajtur një seance dëgjimore.

Me 15 maj 2018, gjykata përsëri kishte mbajtur një seance dëgjimore, mirëpo e njëjta ishte shtyrë për shkak se ende palët ndërgjyqëse nuk e kishin përfunduar marrëveshjen për shitblerjen e paluajtshmërive.

Nga procesverballi vërehet se gjykata kishte kërkuar nga palët që te ta informojnë gjykatën në lidhje me rrjedhën e procedurës.

Me 15 nëntor 2022, gjykata mbajti edhe një seance dëgjimore, ku paditësi deklaroi para gjykatës se e ka përfunduar këtë çështje juridike me të paditurën dhe se i ka blerë parcelat kontestuese që janë objekt i kësaj çështje juridike me datë 29 korrik 2019. Po ashtu paditësi deklaroi se tërheq padinë në këtë çështje juridike, meqë siç tha ai e ka përfunduar këtë çështje në procedurë administrative.

Përfaqësuesi i AKP-së po ashtu në seancë deklaroi se nuk e kundërshton kërkesën e paditësit

për tërheqjen e padisë dhe lidhur me faktin se paditësi e ka përfunduar këtë çështje juridike në procedurë administrative pranë komisionit për negociim të drejtë për drejtë. Gjykatës ja prezantojë kontratën për shitjen dhe bartjen e pronës të arritur bashkë me memorandumun dt. 29 korrik 2019 si dhe vërtetimin e pranimin të kontratës dhe e konsiderojë se padia tani është jolëndore.

Për detaje tjera referim behet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditësit konstatohet e tërhequr.

Neni 34 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parasheh:

“ Paditësi mund ta tërheqë kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme....”

Në seancën dëgjimore të mbajtur me 15 nëntor 2022, paditësi deklaroi se e tërheq padinë në këtë çështje juridike kontestimore, meqë siç tha ai i ka blerë parcelat kontestuese nga e paditura në procedurë administrative me datë 29 korrik 2019.

E paditura nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë nga paditësi.

Andaj nga sa u tha me lart, gjykata jep pëlqimin për tërheqjen e padisë së paditësit, sepse nuk është në kundërshtim me interesin e ndonjë palë.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar Kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Hajrie Shala, Gjyqtare